



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS SË PODUJEVËS

Në mbështetje neneve 11, 12 paragrafi 2 shkronja d), nenin 17 shkronja i) dhe 40 shkronja l) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenet 14, 15 paragrafi 2.4, nenin 19 paragrafi 1.9 dhe nenit 34 paragrafi 2.12 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, (në kërkesë dhe sugjerim të Misionit OSBE në Kosovë), Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 01 shtator 2026, miratoi këtë,

DEKLARATË MBËSHTETËSE

- I. Kuvendi i Komunës së Podujevës shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 nëntor 2024 dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.
- II. Kuvendi i Komunës së Podujevës mbështet gjithashtu Komunikatën Mbështetëse të datës 24 qershor 2025, të nënshkruar nga anëtarë të kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga Misioni i OSBE-së, të mbajtur në Mitrovicë.
- III. Me këtë Deklaratë, Kuvendi i Komunës së Podujevës angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
- IV. Kuvendi i Komunës së Podujevës, strukturat përkatëse komunale përfshirë Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjinore, promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.
- V. Kjo Deklaratë hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Nr.Prot. 01-016/01-0054373/26
Podujevë, datë; 01 shtator 2026

